

V E N D I M
Nr.192, datë 15.4.1999

**PËR SHPRONËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E TOKËS BUJQËSORE TË TETË
FAMILJEVE TË FSHATIT BRURËZ, TË CILAT PËRMBYTEN NGA UJËMBLEDHËSI I
BOVILLËS**

Në mbështetje të neneve 4 e 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 "Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prej 53 798 m2 tokë bujqësore, që përmyten nga ujëmbledhësi i Bovillës, e që ndodhen në territorin e fshatit Brurëz, sipas listës emërore, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listës emërore dhe sipas masës së kompensimit, të cilat paraqiten në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithëshme 25 285 060 (njëzetepesë milionë e dyqindetëdhjetepesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.
 4. Fondi për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt, në buxhetin e shtetit të vitit 1999 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.
 5. Shpronësimi të përfundon brenda datës 31 dhjetor 1999.
 6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Komuna Cudhi, e rrethit të Krujës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

**LISTA EMËRORE E KRYEFAMILJARËVE TË FSHATIT BRURËZ QË DO TË
SHPRONËSOHEN DHE TË KOMPENSOHEN SIPAS V.K.M. NR.297 DATË 15.05.1998**

Nr.	Emri Mbiemri	Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas tapive në m2	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1.	Ali Afmet Mullahi	4728	470	2222160
2.	Bajram Afmet Mullahi	6800	"	3196000
3.	Isuf Tahir Afmeti	4482	"	2106540
4.	Besim Tahir Afmeti	7528	"	3538160
5.	Asllan Tahir Afmeti	11053	"	5194910
6.	Hasan Xhemal Llani	5583	"	2624010
7.	Xhemal Asllan Llani	8718	"	4097460
8.	Mehmet Selman Afmeti	4906	"	2305820
	Shuma	53798	-	2528506 0